



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 31.5.2022

**Lënda:** Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 31.5.2022, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, konfirmuar në detyrë me vendimin nr. 241, datë 26.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Pas prapësimeve të subjektit dhe provave të administruara nga Kolegji, në cilësinë e provës, gjatë hetimit gjyqësor, Komisioneri Publik konstaton si më poshtë:

**1.** *Për pasurinë: Apartament banimi me sip. 71 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “\*\*\*”, në shumën 45.885 euro, subjekti ka deklaruar si burim të ligjshëm për krijimin e saj: (i) kursime nga të ardhurat nga paga ndër vite dhe (ii) hua nga të tretët, në shumën 2.000.000 lekë.*

1.1 Përfundimet e ankimit për këtë shkak janë se subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

1.2 Për sa i përket shkakut ankimor: (i) kursime nga të ardhurat nga paga ndër vite, në analizë të burimit: *Tërheqje depozite nga \*\*\* Bank në shumën 800.000 lekë<sup>1</sup>*, në parashtrimet e datës 26 maj 2022, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim në lidhje me mënyrën e deklaramit të kursimeve *cash/likuiditeteve*, në vitet 2004 dhe 2005, si dhe me disponimin e të ardhurave të mjaftueshme të ligjshme me burim të ardhurat nga paga.

1.3 Në analizë të burimit *15.000 euro kursime të vitit 2005*, në parashtrimet e datës 26 maj 2022, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se mosdeklarimi në Deklaratën “Vetting” i shumës prej 15.000 euro si burim krijimi, nuk mund të konsiderohet si pasaktësi, për sa kohë janë deklaruar si

<sup>1</sup> Depozitë e krijuar në vitin 2003, shtuar me 400.000 lekë gjatë vitit 2004 dhe së bashku me interesat bankare arrijnë totalin prej 1.254.484 lekë, shumë që rezultojnë të jetë tërhequr në *cash* në 23 dhjetor 2004. Në të njëjtën llogari, në datën \*\*.9.2005, është depozituar *cash* shuma 1.700.000 lekë, e cila është tërhequr po *cash* në datën \*\*.10.2005, duke e mbyllur këtë depozitë dhe duke e përdorur këtë shumë për pagesën e apartamentit.

burim “të ardhurat nga pagat”. Subjekti mbajti të njëjtin qëndrim edhe në lidhje me faktin se shuma prej 15.000 euro është në të vërtetë shuma 1.700.000 lekë, që ka si burim shumat e tërhequra në datën \*\*.10.2005, nga depozita te \*\*\* Bank, tërhequr një ditë përpara blerjes së apartamentit. Subjekti pretendoi, gjithashtu, se nuk ka mospërputhje mes deklaramëve, pasi e njëjta shumë e kursyer në thelb nga paga ka pësuar transformime të ndryshme dhe ajo është përpjekur të përshkruajë gjithçka, edhe burimin e krijimit.

1.4 Në analizë të burimit: (iv) *Tërheqje dhe mbyllje depozite në Bankën \*\*\**, në shumën 23.000 USD, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 26 maj 2022, ka mbajtur qëndrimin se deklaramet kontradiktore në deklaramet periodike janë pasojë e mungesës së njohurive në plotësimin e këtyre deklaramëve dhe se burimi i kësaj depozite ishin të ardhurat nga puna ndër vite e subjektit qysh nga viti 1993, kohë kur bashkëjetonte me prindërit në kushtet e një ekonomie të përbashkët familjare, prandaj depozita 23.000 USD është deklaruar si kursime nga të ardhurat familjare në DV-2004.

1.5 Për sa i përket burimit të ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e depozitës së mësipërme, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 26 maj 2022, në mënyrë të përmbledhur ka pretenduar: (i) rishikimin e të ardhurave familjare për periudhën janar 1993 - prill 2002; (ii) përfshirjen në analizën financiare të shumës 1.100.000 lekë, *si rezultat i tjetërsimit nga babai i subjektit të një pasurie e llojit “Tokë arë”, me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup>, sipas dokumentit: Deklaratë Noteriale e datës \*\*.2.1998, e vënë në dispozicion të Kolegjit datë \*\*.4.2022;* (iii) konsiderimin e ekonomisë së përbashkët familjare me prindërit; (iv) mospërfshirjen në analizën financiare të vlerës së blerjes së apartamentit nga vëllai i saj, në vlerën prej 1.800.000 lekë, në vitin 2002; (v) përfshirjen në zërin e të ardhurave të ligjshme, të ardhurat e siguruar nga shitja e prodhimeve bujqësore nga babai i subjektit, bazuar në ekzistencën e dokumentacionit të plotë, që provon përfitimin e këtyre të ardhurave; si dhe (vi) rishikimin e shpenzimeve të jetesës në masën 30% të të ardhurave vjetore.

1.6 Për sa i përket burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, vëllait \*\*\*.\*\*\*, për të dhënë shumën e deklaruar 2.000.000 lekë, në parashtrimet e datës 26 maj 2022, subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, pretendoi se shuma e të ardhurave të vëllait nga emigracioni, sipas akteve të vëna në dispozicion, është në vlerën rreth 37.000 euro dhe, se përveç këtyre të ardhurave, si burim për krijimin e huas së deklaruar kanë shërbyer dhe të ardhurat nga prodhimet bujqësore.

1.7 Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 26.5.2022, paraqiti akte dhe prova mbi mundësinë financiare të familjarëve për të mbuluar me burime të ligjshme shumat e përdorura për blerjen e pasurisë nr.1.

**2. Për pasurinë: Apartament me sip. 62,65 m<sup>2</sup>, ndodhur në Patos, Fier, e padeklaruar në D-Vett.**

2.1 Në përfundim të ankimit lidhur me këtë pasuri, Komisioneri Publik ka vlerësuar se subjekti ka pasur detyrimin ta deklarojë këtë pasuri bazuar në kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit D, pika 1 e aneksit të

Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, gjendet në situatën e deklarimit të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë.

2.2 Në analizë të këtij shkak ankimi, gjatë shqyrtimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendoi, ndër të tjera, se: *është e vërtetë parregullsia ime në plotësimin e Deklaratës “Vetting” lidhur me këtë pasuri, për shkak të një harrrese njerëzore, vendndodhjes së largët, mënyrës së fitimit të pronësisë përmes privatizimit në kohë të hershme, mospërdorimit të saj faktik për një periudhë tejet të gjatë, mosvënies në diskutim të provueshmërisë së ligjshmërisë së burimit për krijimin e kësaj pasurie, mungesës së dashjes për të mos e deklaruar, mungesës së posedimit faktik të kësaj pasurie, vlerës së papërfillshme së saj në raport me pasuritë e saj si subjekt rivlerësimi, ngarkesës në punë, angazhimeve familjare si nënë dhe si bashkëshorte, shkaqeve shëndetësore, urgjencës për të mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për Vetting.*

**3.** *Për pasurinë: “Apartament me sipërfaqe 66 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “\*\*\*”, Tiranë, në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit<sup>2</sup>*

Burimi i krijimit të pasurisë është deklaruar: (i) të ardhura nga paga, të kursyera gjatë viteve; si dhe (ii) të ardhura të krijuara nga qiraja e objektit lokal Bar-Bilardo, Fier.

3.1 Përfundimet e ankimit për këtë shkak janë se subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

3.2 Në analizë të shkakut të ankimit, në përfundim të analizës së parashtrimeve dhe provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit deklaroi, ndër të tjera, se kjo pasuri i përket regjimit pasuror martesor të mëparshëm të bashkëshortit, e krijuar në vitin 2001, kohë në të cilën subjekti nuk ka pasur asnjë lidhje me z. \*\*\*.\*\*\*, duke risjellë në vëmendje të Kolegjit aktin e depozituar<sup>3</sup> pranë Komisionit, si dhe 2 akte shtesë<sup>4</sup> (provat nr. 15 dhe 16). Lidhur me burimin: të ardhurat nga qiraja e godinës 2-katëshe në Fier, për vitet 1996-2001, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj të datës 26.5.2022, ka deklaruar se janë të ardhura të krijuara deri në vitin 2001 (përpara martesë), përfitimi i tyre nga bashkëshorti provohet lehtësisht, pasi kanë qenë të depozituara në bankë dhe vonesa në pagimin e detyrimeve tatimore nuk ka ardhur si pasojë e mosveprimeve të bashkëshortit.

**4.** *Për pasurinë: “Dy garazhe me sipërfaqe 14 m<sup>2</sup>, secili, ndodhur në adresën rruga “\*\*\*”, Tiranë, 100% në pronësi të bashkëshortit të subjektit*

Blerë në vitin 2013, për vlerën 1.300.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. *Burimi i krijimit:* (i) shuma prej 1.000.000 lekë, janë të ardhura të realizuara nga shitja e 10% të aksioneve të bashkëshortit në shoqërinë “\*\*\*” sh. a.; dhe (ii) shuma prej 300.000 lekë, kursime nga paga.

<sup>2</sup> Ky apartament, në D-Vett. deklarohet në vlerën 1.400.000 lekë, ndërsa në DV-2005, çmimi deklarohet 23.000 USD dhe në DV-2007, çmimi deklarohet 25.000 USD.

<sup>3</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë \*\*2.2020, të z. \*\*\* \*\*\* dhe znj. \*\*\*.\*\*\*

<sup>4</sup> Certifikatë familjare, datë \*\*8.2021, lëshuar në bazë të Regjistrimit themeltar të vitit 1974, nga Njësia Administrative nr. \*\*, Bashkia Tiranë, me kryefamiljar shtetasin \*\*\*.\*\*\* (1 fletë) dhe certifikatë familjare, datë \*\*8.2021, lëshuar në bazë të Regjistrimit themeltar të vitit 1974, nga Njësia Administrative nr. \*\*, Bashkia Tiranë, me kryefamiljar shtetasin \*\*\*.\*\*\* (1 fletë).

4.1 Përfundimet e ankimit për këtë shkak janë se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë provuar burimet financiare të ligjshme të deklaruara të përdorura për blerjen e kësaj pasurie.

4.2 Në analizë të shkakut të ankimit, mbi burimin e *shumës 1.000.000 lekë, përfituar nga shitja e 10% të aksioneve të bashkëshortit, në shoqërinë “\*\*\*\*” sh. a.*, në parashtrimet e datës 26 maj 2022, subjekti i rivlerësimit pretendoi se e ka deklaruar saktë burimin për blerjen e këtyre pasurive në Deklaratën “Vetting”, duke depozituar në cilësinë e provës shkresën me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.4.2022, drejtuar znj. Irena Gjoka, me lëndë “Kthim përgjigje”, lëshuar nga ILDKPKI, bashkëlidhur deklarata e interesave private periodike vjetore, viti 2013.

**5. Për pasurinë automjet: “Autoveturë Mercedes Benz, modeli B 180”, me çmim 6.557 euro**

5.1 Përfundimet e ankimit për këtë shkak janë se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait për huan e deklaruar, duke rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë “Autoveturë Mercedes Benz, modeli B 180”, referuar nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

5.2 Në analizë të shkakut të ankimit, mbi burimin e deklaruar: *Hua në shumën 5.000 euro nga babai, z. \*\*\*.\*\*\**, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 26 maj 2022, mbajti të njëjtin qëndrim, duke pretenduar se babai ka pasur aftësi huadhënëse në shumën 5.000 euro, edhe sikur të mos përfshihen të ardhurat nga toka bujqësore.

**6. Për automjetin “Autoveturë Mercedes Benz, modeli ML 270 CDI”, me çmim blerje 15.000 euro**

6.1 Përfundimet e ankimit për këtë shkak janë se rezultojnë mospërputhje në deklarimin e çmimit të blerjes së automjetit Benz-190, duke mbetur i paprovuar çmimi real i blerjes së tij, për të verifikuar nëse rezulton fitim nga transaksioni i shitjes së automjetit, fitim mbi të cilin do të duhej të aplikohet tatimi sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), si dhe mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

6.2 Lidhur me këto përfundime, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 26 maj 2022, mbajti të njëjtin qëndrim, duke pretenduar gabimin në shkrim të bashkëshortit në DV-2006, duke harruar t’i shtojë një 0 (zero) vlerës 600 USD, gabim i korrigjuar në DV-2007, ku është deklaruar saktësisht shuma 6.000 USD, si dhe pamundësinë objektive për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar për të siguruar dokumentacion për dosjen e mjetit.

6.3 Lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar në ankim mbi burimin: *lekë të depozituara në bankë, të tërhequra nga llogaria në USD, në vitin 2006*, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe ka pretenduar se të ardhurat e krijuara të kursyera në vite, nga qiraja dhe shitja e pasurive të paluajtshme e të luajtshme të bashkëshortit, të mbajtura *cash* nga bashkëshorti, të padeklaruara prej tij, për shkak të pakujdesisë dhe moskuptimit të drejtë të ligjit.

**7. Lidhur me shkakun e ankimit: Transaksion në vlerën 12.000 euro në \*\*.7.2007 dhe 10.000 euro në \*\*.3.2002, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit**

7.1 Përfundimet e ankimit për këtë shkak janë se nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, që konsiderohen si provë gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të kenë deklaruar kursime në *cash* në vitet 2005 dhe 2006, për të justifikuar depozitimin e datës \*\*.7.2007.

7.2 Lidhur me këtë përfundim, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 26 maj 2022, ka pretenduar, ndër të tjera, se *Komisioneri nuk ka dhënë asnjë argumentim apo pretendim në lidhje me këto transaksione, që të lidhen me deklaratimet e mia në Deklaratën “Vetting” dhe se objekt i procesit të rivlerësimit janë vetëm pasuritë e deklaruara në Deklaratën “Vetting” së bashku me burimin e tyre.*

**8.** *Lidhur me shkakun e ankimit: Për dy huat e dhëna nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit*

8.1 Përfundimet e ankimit për këtë shkak janë se rezulton që subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar as mënyrat e marrjes së shumave nga bashkëshorti \*\*\*.\*\*\* të huadhënësit \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, dhe as kthimin e tyre, duke pamundësuar kontrollin financiar dhe ligjor të këtyre marrëdhënieve, përkundër detyrimit që ligji i njej.

8.2 Në analizë të shkakut të ankimit dhe në parashtrimet në Kolegj, datë 26.5.2022, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim, duke pretenduar se marrëdhëniet juridike civile janë shuar brenda vitit dhe z. \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* kanë burime të ardhurash të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar huat e dhëna.

**9.** Në përfundim, Komisioneri Publik, në kushtet kur hetimi është shterues dhe i gjithanshëm, bazuar edhe në provat e reja të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit pranë Kolegjit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin në nivel të besueshëm lidhur me kriterin e pasurisë dhe, në përfundim, bazuar në nenin F, pika 7 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i kërkon këtij Kolegji lënien në fuqi të vendimit nr. 241/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**